

## Vizitë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Kosovë

Në datat 13 dhe 14 Qershor 2016, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil zhvilloi një vizitë pune në Kosovë me ftesë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Axhenda e vizitës dyditore përfshiu takime me Kryetarin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Z. Lulzim Aliaj dhe disa anëtarë të këtij Këshilli, Ministrin e Administratës Publike, Z. Mahir Yagcilar dhe Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Z. Qemal Minxhozi, Kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Z. Zenun Pajaziti dhe anëtarë të këtij Komisioni, si dhe Sekretaren e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Znj. Lendita Juniku Pula.

Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i eksperiencave dypalëshe dhe vendosja e urave të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e shërbimit civil. Pas fjalës përshëndetëse të mbajtur nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Z. Lulzim Aliaj dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Znj. Pranvera Strakosha, Kryetari i Këshillit bëri një prezantim të zgjeruar të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të këtij institucioni. Më tej, anëtarë të Këshillit i njohën përfaqësuesit e Komisionerit me procedurat e shqyrtimit të ankesave, procedurat e vëzhgimit të

përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit drejtues, si dhe procedurat e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil. Takimi vijoi me diskutimin e praktikave më të mira, të sfidave dhe vështirësive të të dy institucioneve.



Në fund të takimit, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil shprehën interesin e përbashkët për të bashkëpunuar në të ardhmen nëpërmjet seminareve apo takimeve të përbashkëta.



Gjatë takimit me Ministrin e Administratës Publike të Kosovës, z. Mahir Yagcilar, ky i fundit e informoi Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me reformat e ndërmarra në administratën publike me qëllim arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian. Ministri foli gjithashtu për situatën e administratës publike në Kosovë dhe respektimin e ligjit të shërbimit civil nga institucionet shtetërore.



Komisionerja e falënderoi Ministrin për pritjen dhe bëri një prezantim të shkurtër të punës, sfidave dhe arritjeve të institucionit që nga krijimi i tij e deri më sot dhe në fund, shprehu gatishmërinë për të realizuar bashkëpunime sa më produktive në të ardhmen.



Gjatë takimit me Kryetarin e Komisionit për Administratën Publike, Qeverisjen Lokale dhe Median të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Z. Zenun Pajaziti dhe anëtarë të këtij Komisioni, të dyja palët shprehën kënaqësinë e përbashkët për këtë vizitë të shumëpritur, duke shprehur reciprokisht vullnetin që ky bashkëpunim të thellohet edhe më shumë në vijim. Gjatë takimit, Komisionerja i njohu përfaqësuesit e Komisionit në lidhje me institucionet të cilat bëjnë pjesë në shërbimin civil, kuadrin e ri ligjor, sfidat dhe vështirësitë e hasura gjatë veprimtarisë së institucionit dhe çështje të tjera me interes.



Në fund të vizitës, Komisionerja zhvilloi një takim të shkurtër edhe në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ku u njoh shkurtimisht me përbëjen dhe veprimtarinë e këtij institucioni.

